ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

# Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

**Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:**
Institucioni i Shëndetit Publik Klinika Universitare për kardiokirurgji - Shkup

**Lënda e revizionit:**
Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë të llogarisë për mjetet nga Fondi - 737

**Qëllimi i revizionit:** Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore.

**Gjendjet kyçe të konstatuara:**
- mungesa e procedurave të punës dhe sistemi i painstaluar i kontrolleve të brendshme;
- harmonizimi i paplotësuar i kontabilitetit me gjendjen faktike të mjeteve dhe detyrimeve;
- mospërputhjet dhe kontrolli i pamjaftueshëm gjatë prokurimit të mallrave dhe shërbimeve nga Institucioni Publik;
- mospërputhjet në mënyrën e punësimit të personave të huajë me kontratë pune;
- Pasigurimi i konkurrencë së mjaftueshme dhe mospërputhje gjatë zbatimit të një pjese të prokurimit publik.

**Mendimi i dhënë/përfundim *::**

Të përmbajtur nga dhënia e mendimit në lidhje me të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe mendim me rezervë për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore.

**Rekomandimet kyçe:**
- përgatitjen, miratimin, harmonizimin dhe zbatimin e akteve dhe procedurave të brendshme për rregullimin e proceseve të punës në Klinikë;
- përcaktimi i gjendjes faktike të mjeteve dhe detyrimeve dhe pajtueshmëria e kontabilitetit me gjendjen faktike;
- sigurimin e kontrollit për vërtetimin e pranimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve të dorëzuara nga Institucioni Publik;
- angazhimi i personave të jashtëm të vazhdojë të kryhet në mënyrë të pavarur dhe kuadër të pëlqimit të marrë;
- sigurimin e konkurrencës, proporcionalitetin dhe përdorimin ekonomik të mjeteve gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave në përputhje me kushtet e përcaktuara dhe ofertën e zgjedhur.

**Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë:**
Hapësira në të cilën funksionon Klinika është e pamjaftueshme dhe me marrëdhënie të pazgjidhura pronësore dhe juridike.

**Dobësitë kyçe të sistemit:**
Pavarësisht ekzistimit të detyrimit ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë për të krijuar një sistem kombëtar për operacionet materialo-financiare dhe punë të kontabilitetit në ISHP dhe një sistem qendror për regjistrimin e orarit të punës për nevojat e ISHP-ve, ato nuk janë funksionale

**Vërejtjet e marra të draft-raportit:**
Nuk janë marrë vërejtje mbi draft-raportin e revizorit të autorizuar shtetëror numër 17-172/7 nga 13.12.2021.

* pozitive, me rezervë të pavolitshëm të përmbajtur

ул. Павел Шатев бр.2, Палата „Емануел Чучков", П. Фах 249, 1000 Скопје, Република Северна Македонија
Pallata „Emanuel Çuçkov", rr. Pavel Shatev nr.2, Fax P. 249, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Pavel Shatev Str.2 Palata Emanuel Cuckov, P.O. Box 249, 1000 Skopje, Republic of North Macedonia
T: +38923211262 www.dzr.mk dzr@dzr.gov.mk